



Loja: Lule të thata

Inkurajoni kreativitetin e fëmijës suaj dhe së bashku sillni artin e natyrës në shtëpinë tuaj

Çfarë ju nevojitet për këtë aktivitet:

Lule, peshqirë kuzhine, karton, libra të rëndë, korniza/kartolina për dekorim

Çfarë duhet të bëni:

- Dilni jashtë dhe mblidhni lule të freskëta me fëmijën tuaj.
- Renditni lulet mbi peshqirë kuzhine dhe vendosni sipër një shtresë tjetër peshqirësh.
- Bëni një “sandviç” duke i vendosur ato midis dy shtresave të kartonit.
- Vendosni “sandviçin” nën një libër të rëndë si një enciklopedi, fjalor ose të ngjashëm. Pas disa ditësh, kontrolloni rezultatet.
- Shtypni kornizat/kartolinat dhe ngjitini lulet për të krijuar një kolazh të bukur.

Ky aktivitet është ideal për fëmijët e moshës 3 deri në 6 vjeç. Aktiviteti e inkurajon zhvillimin e aftësive motorike dhe kreativitetin, ndashtu i inkurajon fëmijët të mendojnë logjikisht dhe të lidhen me natyrën.

Në aplikacionin Bebbbo mund të gjenden udhëzimet më të hollësishme për këtë lojë, si dhe shumë ide të tjera për të mësuar përmes lojës.



Ndani punimet tuaja me hashtagun
#BebboMoments
dhe frymëzoni prindërit tjerë!





**Ngjitini
dhe krijoni**

1



2





